



"LIRENG Auditing sh p k.

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 7812/PROT
DATE 21.11.2015

**"PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE SHQIPTARE"
TIRANE**

AUDITIMI PASQYRAVE FINANCIARE

Per Periudhen 1 Janar- 31 Dhjetor 2014

Tirane, Nentor 2015

RAPORTI I AUDITUESIT

Drejtuar : -Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

(Pallati i Kongreseve)

Tirane

- Partise “Aleanca Demokratike Shqiptare”

(Rruga Murat Toptani, Nr.10)

Tirane

Te Nderuar Zoterinj:

Kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te “Partia Aleanca Demokratike Shqiptare” Tirane, te cilat perfshijne bilancin kontabel per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2014, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera ne lidhje me to (anekse).

Pergatitja dhe paraqitja e sinqerte e ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit eshte pergjegjesi e Drejtimit te partise. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit; per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel; si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne kemi kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin tone per te mare sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezeqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te subjektit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektiviten e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te llogjiken e çmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.




“LIRENG Auditing sh p k.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te pergatitura, me nje besueshmeri te aresyeshme japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjet financiare te Partise Aleanca Demokratike Shqiptare me 31 Dhjetor 2014, te rezultatit financiar dhe flukseve te parave per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

 Ekspert Kontabël i Regjistruar
Lic.148. date 21/07/2006



Tirane, Nentor 2015

*SHENIME PLOTESUESE NE LIDHJE ME AUDITIMIN EPARTISE ALEANCA
DEMOKRATIKE SHQIPTARE ,PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2014*

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare”
- Cdo dokument ligjor të marrë prane Partise Aleanca Demokratike Shqiptare .
- Vendimi Nr 969 date 10.08.2015 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PARTINE

Partia“Aleanca Demokratike Shqiptare ” e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, sipas dispozitave perkatase te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”, nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi. Subjekti zgjedhor Partia “Aleanca Demokratike Shqiptare” është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqiperisë me kryetar z. Eduart Abazi ,i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partise “Aleanca Demokratike Shqiptare”. Adresa e subjektit është: Rruga Murat Toptani,Nr.10 Tirane

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ ne baze te parimit te arketim pageses.

ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” sipas parimit te arketim pagesave. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.Per vitin 2014 Partia“Aleanca Demokratike Shqiptare ” nuk ka realizuar të ardhur dhe shpenzime.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Lic.148. date 21/07/2006



Tirane,Nentor 2015

Partia Aleanca Demokratike Shqiptare

DEKLARATE

Pasi u njohem me Vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr. 969 date 10.08.2015, per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara nga Subjektet Politike per vitin kalendarik 01.01.2014 - 31.12.2014,

DEKLAROJME

“Partia Aleanca Demokratike Shqiptare” nuk ka perfituar asnje lloj fondi siç parashikohet ne dispozitat ligjore dhe ne statutin e partise ne perputhje me Ligjin nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Ne deklarojme se nuk kemi asnje kontribut anetaresimi, sponsorizimi, dhurimi e te tjera siç parashikohet nga dispozitat ligjore.

“Partia Aleanca Demokratike Shqiptare” ka keto te ardhura dhe shpenzime per vitin 2014.

PASQYRA E TE ARDHURAVE TE PARTISE ALEANCA DEMOKRATIKE SHQIPTARE PER VITIN 2014					
Nr	Burimet e Financimit	Sipas raportit financiar	Sipas auditimit	Difere nca	Pesha specifike
1	Nga buxheti i shtetit	-	-	-	-
2	Nga fondet e vet Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	-	-	-	-
3	Nga Donatoret(sponsorizime)	-	-	-	-
	-me banke	-	-	-	-
	-me arke	-	-	-	-
	-ne natyre	-	-	-	-
	Gjithsej te ardhura	0	0	0	0
PASQYRA E SHPENZIMEVE TE PARTISE ALEANCA DEMOKRATIKE SHQIPTARE PER VITIN 2014					
1	Shpenzime	-	-	-	-

	Gjithsej shpenzime	0	0	0	0
--	--------------------	---	---	---	---

Kete deklarate ja paraqesim ekspertit kontabel Neshat Maze, i cili eshte caktuar te kryej auditimin e fondeve te perftuara dhe shpenzuara nga "Partia Aleanca Demokratike Shqiptare" per vitin 2014 ,me daten 09.11.2015 per pamundesi objektive nga ana e jone.

Per Partine Aleanca Demokratike Shqiptare

Eduart ABAZI

Kryetar

Tirane me 09.11.2015



LETER ANGAZHIMI AUDITIMI

Z. Eduart Abazi

Kryetar i Partise "Aleanca Demokratike Shqiptare"

Me vendim te KQZ , Nr.969 date 10.08.2015 "*Per Shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar ,te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore per fushaten zgjedhore,per zgjedhjet e per organet e qeverisjes vendore te dates 21.06.2015,si dhe per fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga partit politike per vitin kalendarik 2014*" une Neshat Maze, me license Nr. 148 date 21.07.2006 jam emeruar ekspert kontabel i regjistruar per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare.

Kam kenaqesin qe me anen e kesaj letre t'Ju konfirmoj se e kam pranuar dhe kuptuar kete angazhimi. Mbi kete baze me KQZ-ne lidha Kontraten e Sherbimit te Auditimi Nr. 7697 date 25.09.2015.

Angazhimi do te kete per objektiv te shpreh nje opinion mbi sinqeritetin,vertetesine dhe rregullshmerin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara nga subjekti Juaj gjate vitit kalendarik 2014.

Auditimin do ta kryejme ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme e kryejme auditimin per te mare siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara jane pa anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve,dokumentave dhe evidencave qe mbeshtesin shumat dhe informacionet ne Pasqyrat Financiare gjithperfshirese te hartuara per kete qellim.Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e cmuarjeve kontabel te bere nga Drejtimi , si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te ketyre Pasqyrave Financiare .

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , ne do te vleresojme kontrollin e brendshem qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktojme ato procedura te auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat , por jo per qellimin te shprehjes se opinionit ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit .

Ne zbatim te kerkesave te Standarteve Kontabile dhe Auditimit, pergjegjesia per pergatitjen e Pasqyrave Financiare gjithperfshirese per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara eshte e Drejtimit te Partise.Kjo perfshin mbajtjen e regjistrimeve te duhura kontabel dhe zbatimin e parimeve kontabel. Si pjese perberese e procesit te auditimit ne kerkojme nga drejtimi qe te marrim prej tij konfirmimin me shkrim lidhur me paraqitjet qe do te na behen ne lidhje me kete proces auditimi.

Raporti i Auditimit te Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara qe do te hartohet ne perfundim te auditimit ,se bashku me Shenimet Shpjeguese qe mbeshtesin kete raport,do ti jepet KQZ-se dhe nje kopje Partise Aleanca Demokratike Shqiptare.

Shpresojme te kemi bashkepunim te plote me stafin tuaj dhe besojme se ata do te na vendosin ne dispozicion regjistrat,dokumentacionin dhe informacionin tjetër qe kerkohet per kryerjen e auditimit.

Ju lutemi mendimin duke iu pergjigjur kesaj Letre Angazhimi per te treguar se eshte ne perputhje me kuptimin e Juaj per marrveshjen e lidhur me KQZ-ne per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara gjate vitit 2014 nga "Partia Aleanca Demokratike Shqiptare".

Duke Ju Falenderuar per Bashkpunimin

Me respekt

Neshat MAZE

Ekspert Kontabel i Regjistruar



Tirane , me 04.10.2015.

Pranuar ne emer te Partise Aleanca Demokratike Shqiptare.

Kryetari

Eduart ABAZI

Tirane, me / / /2015

